

VENDIM
Nr.307, datë 16.4.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË INFRASTRUKTURËS
PUBLIKE, NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR**
(ndryshuar me VKM nr. 337, datë 23.4.2020¹)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të nenit 16, dhe të nenit 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit në masën 3 975 401 851 (tre miliardë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e katërqind e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak e Vorë.

2. Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 795 080 370 (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e tetëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm” të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 795 080 370 (shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e tetëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” të buxhetit të shtetit, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

¹ Ndryshuar titulli